

SHPALLJE/THIRRJE PËR APLIKIM NË TRAJNIM ME MUNDËSI PUNËSIMI

Në kuadër të projektit “Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në tregun e kapitalit njerëzor për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit duke prodhuar qese/strajca të tekstilit të ripërdorshme”, The Balkan Forum në partneritet të ngushtë me HANDIKOS dhe të përkrahur nga Zyra Zvicerane për zhvillim në Kosovë, u bënë thirrje personave me aftësi të kufizuar të aplikojnë për trajnim në fushën e rrobaqepësisë-prodhimit të qeseve/strajcave të ripërdorshme.

Pas përfundimit të trajnimit, 10 personave me aftësi të kufizuar do t’ju ofrohet mundësia e punësimit me kohë të caktuar/mundësi vazhdimi.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë persona me aftësi të kufizuar;
- Inkurajohen të aplikojnë gratë me aftës të kufizuara nga të gjitha komunitetet;

Proces i aplikimit:

- Afati për aplikim në trajnim do të jetë i hapur deri me 20 nëntor, 2020.
- Përzgjedhja e personave për pjesëmarrje në trajnim do të bëhet deri me 30 nëntor, 2020.
- 15 persona do të pranohen për të marrë pjesë në trajnim, e ku me pas 10 personave do u ipet mundësia për punë me kohë të caktuar.
- Trajnimi do të fillon me 1 dhjetor.

Aplikimi:

Të gjithë të interesuarit mund ta shkarkojnë formularin për aplikim për trajnim/punë dhe ta dërgojnë të plotësuar në email adresën: handikos@handi-kos.org. Ose duke marrë formularin për aplikimit në zyrat e HANDIKOS Prishtinë. Afati për aplikim do të jetë i hapur deri me 20 nëntor 2020.